

**Vlerësim anti-korrupsion i  
legjislacionit - raport mbi  
Ligjin për energjetikë  
Darko Avramovski**



Projekti "Monitorimi i Suksesit të Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni" është financuar nga  
Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni.

Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe e grantit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se  
shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni.

# Impresum

---

**Titull:** Vlerësim anti-korrupsion i legjisllacionit - raport mbi Ligjin për energjetikë

**Autor:** Darko Avramovski

**Botues:** Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

**Design:** Matea Londza Shumkovska

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<http://www.antikorupcija.mk>

Projekti "Monitorimi i Suksesit të Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni" është financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni.

Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe e grantit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni.

# Hyrje

---

Reformat që synojnë arritjen e integritit të plotë të Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian përfshijnë harmonizimin e rregulloreve nacionale në lidhje me energjinë me standardet dhe rregulloret e BE-së, me qëllim harmonizimin, liberalizimin dhe lidhjen e tregut të energjisë në vendet në Evropë. Në këtë mënyrë, BE kërkon të shmangë monopolizimin e tregut të energjisë, të forcojë konkurrencën e saj, të avancojë hyrjen në tregun e energjisë, ndërsa me këtë të forcohet mbrojtja e konsumatorit, si dhe të përmirësojë efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, të cilat gjithashtu do të kontribuojnë në çmimin e tyre më të ulët në treg. Duke pasur parasysh rëndësinë strategjike të këtij sektori, dhe në përputhje me angazhimet e deklaruara, Komuniteti Energjetik është themeluar si organizatë që duhet të rrisë bashkëpunimin e BE-së me vendet e tjera dhe të arrijë zgjerimin e mëtejshëm të tregut të energjisë, por edhe si organizatë që monitoron progresin e vendeve nga Evropa Juglindore drejt arritjes së kriteve të parashikuara dhe harmonizimit të legjisllacionit kombëtar me legjisllacionin e BE-së.

Si pjesë e aktiviteteve të nevojshme për të harmonizuar rregullativën e brendshme me atë të Bashkimit Evropian, në bashkëpunim me Komunitetin Energjetik, në mënyrë që të sigurojë furnizim cilësor të energjisë, sektor efikas, konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë, mirëmbajtjen dhe

zhvillimin e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energji, duke zvogëluar rrezikun e konfliktit të interesit, si dhe duke inkurajuar përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme për mbrojtjen e mjedisit, Maqedonia e Veriut në maj të vitit 2018 miratoi Ligjin për energjetikë, i cili u ndryshua një vit më vonë, në maj të vitit 2019. Me këtë ligj, ndër të tjera, në përputhje me vendimet e Komunitetit Energjetik, anëtare e së cilës është Republika e Maqedonisë së Veriut, në legjisllacionin vendor janë inkorporuar<sup>1</sup>:

- Direktiva 2009/72 / EC mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike;
- Rregullorja 714/2009 për kushtet për qasje në rrjetet ndërkufitare të shkëmbimit të energjisë elektrike;
- Direktiva 2009/73 / EC mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror;
- Rregullativa 715/2009 për kushtet për qasje në rrjetet e transmetimit të gazit natyror;
- Direktiva 2005/89 / EC për masat për të garantuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe investimet në infrastrukturë;
- Direktiva 2004/67 / EC për masat me të cilat garantohet siguria e furnizimit me gaz natyror;

---

<sup>1</sup> Vendimi i Këshillit Ministror të Komunitetit Energjetik nr. D / 2011/02 / MC-EnC, në dispozicion në: <https://energy-community.org/legal/decisions.html>

• Direktiva 2009/28 / EC për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme si dhe

• Rregullativa 543/2013 për paraqitjen dhe publikimin e të dhënave në tregun e energjisë elektrike.

Si rezultat i kësaj, Ligji rregullon fushë shumë të gjerë, përfshirë dispozitat në lidhje me objektivat dhe mënyrën e zbatimit të politikës energjetike dhe ndërtimin e objekteve energjetike, statusin dhe kompetencat e Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe Shërbimeve Ujore, tregjet e energjisë elektrike, gazin natyror, energjinë termale, si dhe nafta e papërpunuar, derivatet e naftës dhe karburantet për transport, detyrimet për ofrimin e shërbimit publik në tregjet e energjisë elektrike, gazit natyror dhe energji për ngrohje, të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve të energjisë dhe përdoruesve të sistemeve të energjisë, si dhe mënyrën dhe kushtet për të inkurajuar përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, etj. Megjithatë, edhe përkaj asaj se Ligji për energjetikë mbulon shumë segmente të sektorit të energjisë, ai nuk paraqet kodifikim të të gjitha dispozitave që kanë të bëjnë me këtë sektor, kështu që ndër më të rëndësishmet janë dispozitat që kanë të bëjnë me efikasitetin e energjisë, të cilat rregullohen nga Ligji për efikasitet

energjetik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 32/2020), si dhe dispozitat në lidhje me bio-karburantet, të cilat janë përfshirë në Ligjin e vjetër për energjetikë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 16/11, 136/11, 79/13, 164/13, 41/14, 151/14, 33/15, 192/15, 215/15, 6/16, 53/16 dhe 189/16), të cilat në përputhje me nenin 239 të Ligjit për energjetikë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 96/2018 dhe 96/2019) janë akoma të vlefshme. Për më tepër, Ligji i lë më shumë kompetenca Qeverisë, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dhe Komisionit Rregullativ, të cilët me akte nënligjore (dekrete, rregullore, etj.) duhet të rregullojnë zbatimin e Ligjit në mënyrë më të detajuar, dhe si e tillë ndër më të rëndësishmit, që janë pjesë e kësaj analize janë Urdhëresa për masat për mbështetje të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe ndryshimi dhe plotësimi i saj, Rregullorja për burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe ndryshimi dhe plotësimi i saj, si dhe Rregullorja për prodhuesit e autorizuar që përdorin tarifa preferenciale.

Për qëllimet e kësaj analize, u përdor Metodologjia për kontrollim anti-korrupsion të legjislacionit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit<sup>2</sup>, si dhe Analiza dhe Metodologjia Krahasuese e Këshillit Rajonal për Bashkëpunim të Evropës Juglindore dhe Iniciativa Rajonale Kundër korrupsionit<sup>3</sup>.

<sup>2</sup> [https://www.dksk.mk/fileadmin/PDF/Metodologjia\\_za\\_antikorupciska\\_proverka\\_na\\_legislativata.pdf](https://www.dksk.mk/fileadmin/PDF/Metodologjia_za_antikorupciska_proverka_na_legislativata.pdf)

<sup>3</sup> [http://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/06/Comparative\\_Study-Methodology\\_on\\_Anti-corruption\\_Assessment\\_of\\_Laws.pdf](http://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/06/Comparative_Study-Methodology_on_Anti-corruption_Assessment_of_Laws.pdf)

## Rreziqet e zbuluara të korrupsionit dhe konfliktit të interesit në Ligjin për Energjetikë

Ligji për energjetikë në masë të madhe ndjek nomoteknikën Evropiane, duke përkthyer dhe transpozuar dispozitat e direktivave dhe rregulloreve të BE-së, duke vendosur kështu një kornizë solide për rregullimin e sektorit të energjisë. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën dinamike të sektorit energjetik që shpesh kërkon reagime të shpejta, si dhe vëllimin e materies që përfshihet me këtë ligj dhe rregullimi i hollësishëm i të cilit do të kontribuonte në një ligj shumë të gjerë dhe të hollësishëm, rregullim më të hollësishëm të sektorit të energjisë në pajtim me Ligjin për energjetikë kryhet me akte nënligjore, para së gjithash urdhëresa dhe rregullore të lëshuara kryesisht nga Qeveria, Ministria e Ekonomisë dhe Komisioni Rregullator i Energjetikës. Duke pasur parasysh natyrën e akteve nënligjore, shkallën e publicitetit dhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara në miratimin e tyre, kompetencat diskrete të institucionit ose personit kompetent në institucion, si dhe mekanizmat parandalues të disponueshëm për kontrollin e akteve nënligjore, rreziqet më të mëdha për paraqitjen e korrupsionit dhe konfliktit të interesit gjenden pikërisht në këto akte nënligjore që rregullojnë më hollësisht materien e përfshirë me Ligjin për energjetikë.

Para së gjithash, duhet të theksohet se Ligji në vetvete përcakton një kornizë të mirë për ndarjen e pronës, por edhe për shmangien e rreziqeve të tjera nga korrupsioni dhe konflikti i interesit, me një përjashtim të madh, më saktë mosrespektimin e dispozitave të nenit 22 të Ligjit për energjetikë me dispozitat e nenit 8 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe

konfliktit të interesave, në lidhje me përkufizimin për persona të afërt. Kështu, në nenin 22 të Ligjit për energjetikë përcaktohet se "Kryetari, anëtar ose punonjësi i shërbimit profesional të Komisionit Rregullator të Energjetikës, si dhe *bashkëshort i tyre ose personi i afërm i brezit të parë*, nuk mund të jetë mbajtës ose kërkues i licencës për kryerjen e veprimtarisë energjetike, aksionar, ortak ose anëtar i organeve të menaxhimit dhe mbikëqyrjes së personave që janë mbajtës ose kërkues të licencës për kryerjen e veprimtarisë energjetike". Është e qartë se neni konkret nuk ndjek përcaktimet e vendosura për person të afërm, kështu që në këtë nen përfshihen vetëm bashkëshorti dhe personi i brezit të parë, duke lënë jashtë partnerët jashtëmartesor, të afërmit sipas gjakut deri në brezin e parë dhe në vijë anësore deri në brezin e katërt, të afërm krushq deri në brezin e dytë, si dhe çdo person fizik ose juridik me të cilin personi zyrtar ka interes financiar. Në këtë mënyrë, Ligji për energjetikë praktikisht nuk i plotëson kriteret për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit kur bëhet fjalë për kufizimin përkatës të interesave të anëtarëve ose punonjësve të Komisionit Rregullator me persona që marrin pjesë në çfarëdo mënyre në tregun e energjisë. Me këtë, Ligji lë hapësirë të gjerë në praktikë të paraqiten situata në të cilat kryetari, anëtari ose punonjësi i Komisionit Rregullator është në marrëdhënie të caktuar me një person i cili është mbajtës ose kërkues i licencës për të kryer veprimtari energjetike ose anëtar i organeve drejtuese të një personi juridik i cili është mbajtës i licencës ose kërkues, në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konflikt të interesave.

Është e rëndësishme të theksohet se ky nen në thelb është rreziku më i madh specifik për korrupsion ose konflikt të interesave që mund të gjendet në dispozitat ligjore, përkatësisht që ka të bëjë me formulimet jo përkatëse të tekstit në Ligj. Kjo situatë është kryesisht për shkak të faktit se Ligji përcakton vetëm kornizë në të cilën me akte nënligjore rregullohet në detaje sektori i energjetikës. Në këtë drejtim, siç u përmend më herët, për shkak të vetë natyrës së akteve nënligjore dhe procedurave për miratimin e tyre, hapësira e madhe për rregullimin e sektorit energjetik me akte nënligjore kontribuon në mënyrë të pashmangshme në rritjen e rreziqeve të korrupsionit ose konfliktit të interesit. Si një fushë specifike që tërheq vëmendje të veçantë në këtë kontekst është pikërisht rregullimi i prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, i rregulluar nga nenet 172 deri 194 të Ligjit për energjetikë. Sipas këtyre dispozitave ligjore, prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme rregullohet me akte nënligjore, nga të cilat më të rëndësishmet janë:

- Urdhëresë mbi masat për mbështetjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe ndryshimet e tij të miratuara nga Qeveria e RMV-së, të cilat rregullojnë llojet e teknologjisë dhe kushtet që elektro centrali duhet të plotësojë për të fituar mbështetje nga shteti, llojin e mbështetjes, si dhe kushtet, mënyrat dhe kohëzgjatjen e tyre, si dhe
- Rregulloren për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë dhe ndryshimet e tij të miratuara nga Ministria e Ekonomisë, të cilat rregullojnë llojet e elektrocentraleve që konsiderohen burime të ripërtëritshme të energjisë, kushtet dhe mënyrën e dorëzimit të energjisë së tepërt, mënyrën e lëshimit, transferimit dhe zbritjen e garancive për origjinën e energjisë dhe të ngjashme.

Në përputhje me nenet 186 dhe 187 të Ligjit, prodhuesit e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme janë prodhues preferencial të energjisë elektrike dhe si të tillë kanë të drejtë për mbështje nga shteti, gjë që manifestohet kryesisht përmes tarifës preferenciale për blerjen e energjisë së prodhuar, përkatësisht përmes çmimit më të favorshëm të shitjes së kësaj lloji energjie. Në përputhje me nenin 185, Qeveria përshkruan masat për mbështetjen e prodhuesve preferencial, llojet e elektrocentraleve që konsiderohen si burime të ripërtëritshme të energjisë, si dhe kushtet dhe mënyrat për marrjen e statusit të prodhuesit preferencial dhe përdorimin e masave. Kështu, me Urdhëresën për masat për mbështetjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë përcakton se termocentralet që përdorin ekskluzivisht burime të ripërtëritshme të energjisë, dhe të cilat mund të përdorin tarifë të autorizuar, bëjnë pjesë hidrocentrale me kapacitet të instaluar deri në 10 megavat (hidrocentrale të vegjël) parqet eolike me kapacitet të instaluar deri në 50 megavat, termocentralet me biomasa ose me biogaz me fuqi deri në 1 megavat, ndërsa periudha e përdorimit të tarifës preferenciale është 20 vjet për hidrocentralet dhe parqet eolik, si dhe 15 vjet për termocentralet me biomasa ose biogaz. Me këtë është e lidhur ngushtë Rregullorja për prodhuesit preferencial që përdorin tarifat preferenciale të Komisionit Rregullativ, i cili rregullon procedurën për marrjen e statusit të prodhuesit preferencial dhe fitimin e të drejtës për të përdorur tarifë preferenciale, si dhe Rregulloren për burimet e ripërtëritshme të energjisë të Ministria e Ekonomisë e cila rregullon mënyrën e blerjes së energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme, përkatësisht e cila, në përputhje me Ligjin për energjetikë, përcakton prioritetet e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme. Prandaj lind pyetja pse këto dispozita shpërndahen në 3 akte nënligjore dhe



nuk janë pjesë integrale e tekstit ligjor, duke pasur parasysh rëndësinë e tyre për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme? Mungesa e sistematizimit dhe pasqyrit të qartë të këtyre dispozitave, për faktin se ato rregullohen nga akte të ndryshme nënligjore, të plotësuara me caktimin e sipërpërmendur jo të plotë të konfliktit të interesit, anëtarët e Komisionit Rregullativ me persona të afërm me ta rrit në mënyrë të pashmangshme rrit rrezikun e korrupsionit dhe konfliktin e interesave, veçanërisht në përdorimin e masave për mbështetje nga prodhuesit e energjisë së rinovueshme.

Një faktor shtesë rreziku është periudha relativisht e gjatë për të cilën jepet përdorimi i tarifës preferenciale, veçanërisht për hidrocentralet e vogla dhe parqet eolike, e cila është 20 vjet. Duke qenë se argumenti kryesor për nevojën e rregullimit të një pjese të çështjes me akte nënligjore është pikërisht fleksibiliteti në trajtimin e ndryshueshmërisë së kushteve dhe zhvillimit të teknologjisë për prodhimin e energjisë elektrike, periudha prej 20 vjet mund të jetë e padobishme në plan afatgjatë. Kjo është pikërisht për shkak të avancimit të teknologjisë që mund të mundësojë prodhim më të lirë të energjisë elektrike, për shkak të së cilës tarifa preferenciale me të cilën blihet pas një periudhe të caktuar kohore mund të bëhet e shtrenjtë dhe e pafavorshme për vendin. Kësaj i shtohet edhe fakti se masat mbështetëse synojnë, ndër të tjera, të përshpejtojnë avancimin e teknologjive për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, si dhe të inkurajojnë

përdorimin më të madh të energjisë prej tyre, prandaj është e nevojshme për masat mbështetëse që korrespondojnë me zhvillimin e teknologjisë.

Duke marrë parasysh që në publik disa kohë debatohet në lidhje me efektin e vërtetë të hidrocentraleve të vogla mbi mjedisin jetësor, në kuadër të kësaj analize u vërejt se në Ligjin për energjetikë dhe aktet nënligjore në lidhje me to, nuk ka kritere të qarta për mbrojtjen e mjedisit jetësor të cilët prodhues të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme duhet t'i plotësojnë. Pa hyrë në arsyetimin ekologjik të ndërtimit të llojeve të caktuara të centraleve për prodhimin e energjisë elektrike, mungesa e dispozitave të qarta në lidhje me kriteret dhe detyrimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor që duhet të përmbushen paraqet një rrezik të veçantë nga korrupsioni. Megjithëse ky lloj hendeku ligjor mund të kontribuojë në rrezikimin e mjedisit jetësor, mund të ndikojë në shfaqjen e praktikave të ndryshme dhe të vendosë kritere të pajustificueshme të ndryshme në raste të ndryshme, por gjithashtu ndikon drejtpërdrejt në mundësinë për keqpërdorim dhe korrupsion. Megjithëse në praktikë është vërtet e vështirë të vendosen kritere të para përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor, megjithatë, mungesa e plotë e parashikueshmërisë në lidhje me kushtet që duhet të plotësojnë centralet nga burime të rinovueshme në aspektin e standardeve minimale për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe monitorimin e efektit afatgjatë që këto centrale kanë mbi ekologjinë në mjedisin e tyre.

---

<sup>4</sup> [http://ombudsman.mk/MK/predmetno\\_rabotnje/godishni\\_izveshtai.aspx](http://ombudsman.mk/MK/predmetno_rabotnje/godishni_izveshtai.aspx)

## Përfundime dhe rekomandime

---

Vërejtjet kryesore në lidhje me analizën anti-korrupsion të Ligjit për energjetikë dhe akteve nënligjore përkatëse janë pikërisht në lidhje me kompetencat e gjera të pushtetit ekzekutiv dhe Komisionit Rregullativ, të cilët përmes akteve nënligjore janë kompetentë për të rregulluar në mënyrë më të detajuar procedurat për autorizim për ndërtimin e impianteve për energji, marrjen e statusit të prodhuesit preferencial nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, si dhe masat mbështetëse që u përkasin këtyre prodhuesve, kohëzgjatja, lloji dhe lartësia e tyre. Një rrezik shtesë që ndërlidhet me këtë është shpërndarja e disa dispozitave të lidhura me rregulloret përkatëse, duke përfshirë 3 ligje dhe dhjetëra akte nënligjore, njëra prej të cilave është urdhëresa e dhe e Qeverisë dhe disa rregullore të ministrive kompetente dhe Komisionit Rregullator. Në këtë kontekst, është e nevojshme të bëhen përpjekje për të mundësuar kodifikimin e duhur të të gjitha rregulloreve që lidhen me energjetikën në një akt, ose ndarjen dhe grupimin e duhur të dispozitave të veçanta në disa ligje të ndryshme.

Megjithëse vetë Ligji përcakton një kornizë të mirë për rregullimin e sektorit të energjetikës, si dhe sigurimin e garancive për shmangien e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, devijime të vogla por jo të parëndësishme nga standardet për rregullimin e konfliktit të interesit zbulohen në dispozitat e ligjit. Në këtë drejtim, rekomandimi i parë i referohet nenit 22 të Ligjit për energjetikë, me qëllim të mundësohet pajtueshmëri e plotë me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, është e nevojshme që në paragrafin 1 të nenit, si persona të afërt me kryetarin, anëtarët dhe punonjësit në shërbimin profesional të Komisionit Rregullator, të

shtohen dhe partnerët jashtëmartesor, të afërmit e gjakut të brezit të parë dhe më të largët deri në brezin e katërt, të afërmit në bazë të krushqisë deri në brezin e dytë, si dhe çdo person fizik ose juridik me të cilin kryetari, anëtarët dhe të punësuarit në Komisionin Rregullator kanë interes financiar. Kjo do të forcojë mekanizmat e garancisë që duhet të kontribuojnë në minimizimin e shfaqjes së korrupsionit dhe konfliktit të interesit, duke parandaluar keqpërdorimin me pozicionin zyrtar të anëtarëve ose punonjësve të Komisionit Rregullator dhe me shmangien e mundësisë që të afërmit e tyre të përfitojnë në mënyrë të paligjshme.

Siç është theksuar tashmë, hapësira e madhe për rregullimin e çështjes me aktet nënligjore paraqet në mënyrë të pashmangshme rrezik në rritje nga korrupsioni dhe konflikti i interesit, kryesisht për shkak të shkallës së ndryshme të kontrollit, transparencës dhe përfshirjes gjatë miratimit të këtyre akteve. Kjo është veçanërisht e evidente kur bëhet fjalë për rregullimin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, të cilat, përveç dispozitave themelore që përcaktojnë kornizën e përgjithshme, praktikisht rregullohen plotësisht nga disa akte nënligjore. Me identifikimin se sektori energjetik është specifik, dinamik dhe i ndryshueshëm, në mënyrë të pashmangshme është pjesë e rregullimit me akte nënligjore, të cilat do të lejonin adresimin në kohë, të nevojave që lindin si rezultat i çdo ndryshimi në shoqëri ose sektor, megjithatë aktet nënligjore zakonisht vendosin zgjidhje afatgjata dhe të forta kur bëhet fjalë për rregullimin e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, për shkak të të cilave mbetet e paqartë pse këto dispozita bëjnë pjesë në një akt nënligjor, në

vend në vetë Ligjin. Rekomandimi në këtë kontekst është që të integrohen shumica e dispozitave të akteve nënligjore në vetë Ligjin për energjetikë, ose të miratohet një Ligj i ri dhe i veçantë për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme. Kjo do të forconte kompetencat dhe ndikimin e Kuvendit si dhoma më e lartë përfaqësuese e qytetarëve mbi sektorin energjetik, dhe posaçërisht në prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme. Përveç kësaj, vetë ajo që këto dispozita do të rregulloheshin me ligj do të parandalonte ndryshimin e lehtë dhe arbitrar të dispozitave nga pushteti ekzekutiv, dhe do të lejonte shkallë më të madhe të kodifikimit të dispozitave që sigurisht do të ndikonin në parashikueshmërinë ligjore, ndërsa me këtë edhe zvogëlimin e rreziqeve nga korrupsioni për shkak të interpretimeve të ndryshme të dispozitave, dhe së fundmi do të mundësonte përfshirjen më të madhe të palëve të interesuara në miratimin dhe ndryshimin e dispozitave për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme.

Përveç kësaj, ekziston nevoja për rishikim të plotë të tarifave preferenciale të cilat u jepen prodhuesve të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, të cilat në një mënyrë përfaqësojnë çmim të subvencionuar për blerjen e kësaj energjie nga shteti. Periudha e gjatë prej 20 vjetësh për të cilën jepen këto tarifa preferenciale mund të jetë joproduktive për shtetin, dhe mjaft të favorshme për personin që prodhon energji nga burime të rinovueshme, ndërsa më e rëndësishmja për nevojat e kësaj analize, kjo rrit rreziqet nga korrupsioni në procedurat për dhënien e tarifave të tilla. Nëse kjo shihet në kontekstin e veçimit jo të plotë të të gjithë personave të afërm të anëtarëve dhe punonjësve të Komisionit Rregullator të cilët mund të fitojnë të drejtën për të përdorur tarifë preferenciale, rreziku për paraqitjen e korrupsionit ose konfliktit të interesit bëhet rrezik real.

Diskutuar në këtë kontekst, mungesa e standardeve dhe kriterëve për mbrojtjen e mjedisit jetësor në ndonjë prej akteve që lidhen me procedurën për marrjen e statusit të prodhuesi preferencial i cili mund të përdorë masa mbështetëse, rrit më tej rreziqet për korrupsion. Për më tepër, duke pasur parasysh që burimet e ripërtëritshme të energjisë po avancohen dhe promovohen pikërisht me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësor dhe parandalimin e efekteve të padëshirueshme mbi të, mungesa e të paktën standardeve minimale të tilla është problem që duhet të adresohet në mënyrë përkatëse sa më shpejt të jetë e mundur. Për shkak të kësaj, mbetet rekomandimi për miratimin e një ligji të veçantë për burimet e ripërtëritshme të energjisë, i cili do të rregullonte në mënyrë më të detajuar rregullat e procedurave për marrjen e statusit të tillë, si dhe kriteret dhe standardet minimale që duhet të përmbushen në drejtim të mbrojtjes së mjedisit jetësor. Kjo do të rrisë parashikueshmërinë dhe sigurinë ligjore, e cila në mënyrë të pashmangshme do të zvogëlojë rreziqet e korrupsionit dhe konfliktit të interesit. Një alternativë ndaj kësaj do të ishte vendosja e rregullave dhe standardeve më të hollësishme për matjen e efekteve të centraleve për prodhimin e energjisë elektrike mbi mjedisin jetësor, si dhe detyrimet dhe kompetencat në lidhje me ruajtjen e mjedisit.

Përfundimisht, është e nevojshme të forcohet kontrolli mbi Komisionin Rregullator nga Kuvendi, si dhe kontrolli mbi vendimet e marra në nivelin e aktit nënligjor, veçanërisht nëse nuk inicohet miratimi i një ligji të veçantë që rregullon prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Kjo do të zvogëlojë rrezikun e arbitraritetit nga pushteti ekzekutiv në përshkrimin e kushteve dhe mënyrave për të marrë masa të caktuara mbështetëse, dhe gjithashtu do të rrisë kompetencat dhe ndikimin e Kuvendit në sektorin energjetik, si një sektor strategjik jashtëzakonisht i rëndësishëm për të gjithë vendin dhe të gjithë qytetarët e saj.







**ПЛАТФОРМА**  
на граѓански организации  
за борба против корупцијата



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА  
OPEN OTBOPENO  
SOCIETY OPICTEBO  
MACEDONIA MAKEDONIJA